



INFRAKOS SH.A

NDERMARRJA PUBLIKE

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS SH.A

Adresa: „Sheshi lirisë“ nr. 36 Fushë Kosovës, www.infrakos.com +383 550 550 500

Rregullore

për sigurinë, shëndetin dhe mjedisin e punës

Fushë Kosovë
2025

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe akteve nënligjore të këtij ligji, Ligjin e Punës Nr.03/L-212, dhe akteve nënligjore të këtij ligji, në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 04/L-111, për plotësim ndryshimin e ligji Nr. 03/L-087, nenin 34 të ligji Nr. 03/L-087 për ndërmarrje publike, nenin 15, paragrafi 15.2.3 pikat (a), të Statutit të ndërmarrjes Nr. 2/52 datë 09/07/2024, Bordi i Drejtorëve i NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS Sh.A me datë 31/07/2025, aprovon këtë:

R R E G U L L O R E

PËR SIGURINË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me Rregulloren për siguri në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, rregullohen të drejtat, detyrat, zbatimi i masave për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe obligimet e punëtorëve (punëmarrëseve) nga siguria në punë, organizimi i mbrojtjes në punë, duke siguruar kushte optimale për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet dhe dëmtimet e mundshme në vendin e punës, detyrat dhe obligimet e organeve përgjegjëse të punëdhënësit për sigurimin e kushteve optimale nga siguria në punë.

Neni 2

Dispozitat ligjore që e rregullojnë lëmin e sigurisë në punë aplikohen drejtpërsëdrejti dhe INFRAKOS SH.A. është i obliguar që t'i respektoj ato dispozita.

Neni 3.

1. Të drejtat për siguri në punë dhe mbrojtje të shëndetit, INFRAKOS SH.A., është i obliguar t'iu siguroj.
 - a. punëmarrësit që kanë themeluar marrëdhënie pune,
 - b. personat që janë në aftësim profesional të punëdhënësi, të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie pune,
 - c. personat në rikualifikim profesional dhe trajnim,
 - d. nxënësit dhe studentët të cilët të punëdhënësi kryejnë punë praktike.
 - e. pjesëmarrësit në punë vullnetare apo punë tjera publike, të organizuara për interes të përgjithshëm,
 - f. personave të cilët gjatë vuajtjes së dënimit të cilët angazhohen në kryerjen e punëve në ambientet e INFRAKOS SH.A., sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit i'a siguron organi shtetëror i cili i angazhon në këto punë.
 - g. personat të cilët ndodhen në vendet e punës (bashkëpunëtorët afarist, përfaqësuesit e administratës shtetërore, shfrytëzuesit e shërbimeve).

II. ORGANIZIMI I SIGURISË NË PUNË

Neni 4

INFRAKOS-i organizon punët profesionale të sigurisë në punë nëpërmjet Zyrës së Sigurisë dhe Emergjencave në kuadër të Shërbimit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë, si zyrë profesionale, preventive dhe me funksion këshillëdhënës dhe koordinues me nivelin operativ në funksion të kërkimit dhe implementimit të rregullave dhe standardeve në punë si dhe urdhërdhënës për situata të shkallës së lartë të rrezikshmërisë për punëtor dhe pajisje të udhëhequra nga Shefi i shërbimit për Mbrojtjeje dhe Siguri në Punë në INFRAKOS SH.A.

Neni 5

1. Me këtë rregullore përcaktohet se çka konsiderohet aksident në punë me pasoja lëndimi:
2. Aksident në punë me pasoja lëndimi konsiderohet:
 - a) Gjatë kryerjes së punës në subjektin e punës ku është i punësuar;
 - b) Gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa ose me urdhër të punëdhënësit për arsye madhore në interes të punës;
 - c) Gjatë kohës së pushimit të përcaktuar nga punëdhënësi, vënien në rregull të makinerive, veglave të punës veshmbathjeve, pastrimit të vendit të punës, para ose pas mbarimit të punës ;
 - d) Gjatë kohës së aftësimin dhe trajnimit profesional;
 - e) Gjatë dhënies së ndihmës së parë lidhur me punën;
3. Nuk konsiderohet lëndim në punë nëse lëndimi është provokuar nga dashja apo pakujdesia ekstreme e punëmarrësit që nënkupton se lëndimi nuk ka ndodh në procesin e punës, nga mjetet e punës,
4. Lëndim në punë nuk konsiderohen rastet me fatalitet, nëse pasoja nuk ka lind nga shkak i lëndimit, por nga sëmundja dhe atëherë kur rasti ndodhë në objektet e INFRAKOS-it.
5. Përmes hulumtimit të rastit do të konstatohet se aksidenti i ndodhur me pasoja të lëndimit të punëmarrësit bie në kategorinë e alinesë paraprahe nën pikën a, b, c, d, e, dhe varësisht nga kategoria e cekur do të lëshohet fletë lëndimi .
6. Fletë lëndim nuk do të lëshohet për rastet nga pika c dhe d.
7. Të aksidentet me fatalitet është obligim që të lajmërohet Inspektorati i punës dhe kompania e sigurimeve nëse punëmarrësi ka sigurim.
8. Të lëndimet e personave të tretë nga mjetet – asetet (sendet) e INFRAKOS SH.A., është e domosdoshme që të krijohet Komisioni Profesional për konstatimin e shkaqeve të ndodhjes së aksidentit.
9. Komisionin e formon Kryeshefi Ekzekutiv i INFRAKOS-it, por mund ta formoj edhe Menaxheri i departamentit me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv.
10. Për aksidentet me invaliditet të përkohshëm dhe përhershëm dhe rastet që përfundojnë me fatalitet, Komisioni duhet të jetë ad-hoc.
11. Nuk lëshohet fletë lëndim për persona të tretë të aksidentuar nga asetet e INFRAKOS-it.

Neni 6

1. Hulumtimin e ngjarjes e kryen personeli i autorizuar i Sigurisë në punë, veçmas apo me Komision profesional të formuar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv.
2. Në te dy rastet hartohet procesverbal me shkrim, incizimi i vendit të ngjarjes, marrja e deklaratave nga dëshmitarët dhe personelit përgjegjës si dhe vet personelit të aksidentuar kur për këtë të krijohen kushtet.
3. Procesverbali i plotësuar me foto incizim i dërgohet menaxherit të departamentit dhe Kryeshefit Ekzekutiv me qëllim të eliminimit të shkaqeve të lëndimit dhe mos përsëritje të tij si dhe Zyrtarit të Sigurisë të INFRAKOS-it.

Neni 7

1. Fletë lëndimin e plotëson mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i punëtorit të lënduar në punë, në afat prej 24 orë, e më së largu në afat prej 48 orë për raste vikendi dhe festa.
2. Në raste të veçanta (lëndime të rënda) Kryeshefi Ekzekutiv formon komisionin profesional për të përcaktuar shkakun aksidentit.
3. Në rast se kemi aksidente të lehta mbikëqyrësi i drejtpërdrejt dhe zyrtari i sigurisë në punë konstatojnë shkakun e aksidentit i cili përshkruhet në flet lëndim.
4. Fletë lëndimin e nënshkruajnë:
 - a) Mbikëqyrësi i drejtpërdrejte.
 - b) Zyrtari i Sigurisë në Punë.

- c) Kryeshefi Ekzekutiv.
- 5. Fletë lëndimi i plotësuar dhe nënshkruar i dërgohet institucionit shëndetësor të autorizuar me të cilin ka kontratë INFRAKOS Sh. A. dhe plotësohet nga mjeku përkatës.
- 6. Konstatimin dhe vlerësimin e shkallës së paaftësisë invaliditetit e jep komisioni mjekësor.

Neni 8

Për secilin rast të aksidentit apo incidentit në punë, personi përgjegjës i njësisë/shërbimi ka për obligim që menjëherë ta njoftojë zyrtarin për siguri në punë, nëpërmjet postës elektronike ose me telefon.

Neni 9

Raportet e standardizuara javore dhe mujore përdoren nëpër secilin departament, Sektor, Shërbim. Ato do të përmbanin hollësi për lëndimet dhe aksidentet që kanë ndodh gjatë periudhës raportuese dhe përfshirjen e çështjeve të sigurisë të paraqitura dhe evituara. Gjithashtu, këto raporte duhet të mbarëshojnë brengat kryesore në aspektin e sigurisë dhe çdo trajnim të organizuar të personelit.

Neni 10

1. Për zbatimin dhe ngritjen e sigurisë në punë dhe emergjenca zyrtaret kompetent i kryejnë këto punë, por jo vetëm :
 - a. Mbikëqyrin dhe monitorojnë respektimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore;
 - b. Hartojnë dhe zhvillojnë dokumentacionin, politikat dhe procedurat të cilat kërkohet nga legjislacioni dhe standardet të cilat mbulojnë sferën e sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore;
 - c. Planifikojnë, hartojnë programin dhe koordinojnë punën në fushën e sigurisë në punë, mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore në koordinim me përgjegjësit në departamente/ sektorë përbrenda INFRAKOS-it.
 - d. Marrin pjesë në aktivitetet e hartimit të politikave të sigurisë në punë mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore ;
 - e. Marrin pjesë në hartimin e raportit periodik të sigurisë në përputhje me ligjin për hekurudhat e Kosovës, për fushën e sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore;
 - f. Identifikon dhe analizon burimet dhe shkaqet e lëndimeve në punë dhe dëmtuesve të shëndetit dhe propozon masa për largimin dhe pengimin e tyre;
 - g. Kontrollon zbatimin e masave dhe rregullave të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes kundër zjarrit, sipas rregullave të përcaktuara me Ligje dhe akte nënligjore në fuqi si dhe anekseve të kësaj rregullore dhe vendimeve të organeve kompetente nivel vendi dhe organeve të INFRAKOS-it
 - h. Harton plane dhe studion rregullat Ligjore nga lëmi i sigurisë në punë dhe bënë me dije për obligimin e zbatimit të domosdoshëm të rregullave dhe propozon ndërrimin e rregullave sipas nevojës.
 - i. Bashkëpunon me të gjitha strukturat në INFRAKOS me qëllim të organizimit, mbikëqyrjes dhe përparimit të sigurisë në punë.
 - j. Menaxhon dhe analizon me statistikat e raportimeve të aksidenteve dhe incidenteve si dhe sëmundjeve profesionale dhe raporton një herë në muaj organet menaxhuare dhe komitetin e sigurisë në INFRAKOS.
 - k. Mbikëqyrë dhe koordinon kontrollimet periodike të gjendjes shëndetësore të punëtorëve.
 - l. Kontrollon se a po bëhen shqyrtimet dhe matjet periodike të: pajisjeve dhe mjeteve, dëmtuesve kimik-biologjik, të mikroklimës etj. Disa nga këto punë i kryejnë vetë personeli i sigurisë në subjektet varësisht nga autorizimet.
 - m. Propozon hapjen e procedurës kundër personave përgjegjës për lëndimin e rregullave dhe mospërfillje të masave të sigurisë në punë,
 - n. Personeli i sigurisë është i autorizuar të ndaloj përkohësisht punën në vendet e punës të rrezikshme për punëtorë dhe për pajisje, dhe për këtë e njofton Udhëheqësin e zyrës gjegjësisht. Udhëheqësin e Departamentit dhe Sektorit apo shërbimit të subjektit në të cilin është ndaluar puna, si dhe Kryeshefin Ekzekutiv.

- o. Bashkëpunon me organe vendore dhe regionale si dhe me institucione të ndryshme nga kjo lëmi.

Neni 11

1. Me qëllim të implementimit të masave të sigurisë zyrtaret për siguri kryejnë këto punë:
 - a. Mban evidenca për aksidente dhe incidente në punë dhe raporton Kryeshefin Ekzekutiv dhe strukturat relevante për ngjarjen. Gjithashtu analizon dhe hulumton rastin e aksidentit në punë dhe përgatitë Raportin e ngjarjes.
 - b. Organizon dhe kontrollon vizitën e punëtorëve në kontrollime sistematike mjekësore dhe i raporton mbi gjendjen shëndetësore apo gjendjen invalidë / i përkohshëm apo i përhershëm/ të personelit, Drejtorit Ekzekutiv dhe Menaxhmentit relevant në INFRAKOS.
 - c. Harton planin e kontrollimit të pajisjeve dhe stabilimenteve të departamenteve me qëllim të avancimit të gjendjes së sigurisë për punëtor dhe objekte. Me këtë rast i raporton udhëheqësit të subjektit me shkrim mbi gjendjen dhe afatet e eliminimit të jo-konformiteteve apo shakatarëve të mundshëm të aksidentit dhe incidentit në punë. Për gjendjen e konstatuar informon KE dhe përgjegjësin për siguri në Sektorin përkatës. Kontrollimin e bënë personeli i sigurisë veçmas apo me personelin e drejtpërdrejtë të procesit.
 - d. Kontrollimi i gjendjes teknike të pajisjes, veglave të punës, proceseve teknologjike, ambientit të punës së punëtorëve kryhet për mes metodave bashkëkohore të hulumtimit dhe vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë përmes standardeve të observimit.
 - e. Krijimi i standardeve të Observimit dhe raportimit, koordinohen me Udhëheqësin e Zyrës për Kujdes Shëndetësor, Siguri dhe Mbrojtje në Punë në INFRAKOS.
 - f. Personeli i sigurisë është i obliguar për hapjen e procedurave disiplinore ndaj personelit të cilët i shkelin rregullat e sigurisë të parapara me këtë Rregullore dhe Kodin disiplinor të INFRAKOS-it.

Neni 12

Kontrollimin e zbatimit të masave të sigurisë në punë në njësi dhe shërbime në INFRAKOS e kryen Zyrtarët për Siguri në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me koleget e profesionit tjetër dhe udhëheqësin e drejtpërdrejtë të njësisë të mbikëqyrur apo Sektorit / Departamentit.

Neni 13

Për organizimin e kushteve dhe zbatimin masave të sigurisë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimet e ndryshme për të siguruar, mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës, mundësit për të shkuar në vendin e punës, brenda INFRAKOS-it, përgjegjës është punëdhënësi, respektivisht udhëheqësi që udhëheqë me njësinë përkatës sipas skemës organizative.

Neni 14

Për zbatimin e masave dhe rregullave të sigurisë në punë përgjegjës është çdo i punësuar në INFRAKOS si dhe çdo person që për arsye të ndryshme ndodhet në ambiente të INFRAKOS -it. Operatorët ekonomik si dhe kontraktuesit e tyre janë të Obliguare t'i përmbahen Rregullave të Sigurisë sipas kësaj Rregullore dhe Ligjeve në fuqi.

Neni 15

INFRAKOS obligohet që për të punësuarit e vet të siguroj mjete financiare për furnizim me PPM-Pajisje Personale Mbrojtëse dhe ndihmës së parë.

Neni 16

Çdo njësi sipas skemës organizative duhet të ketë në posedim barnatoren e pajisur me material të nevojshëm për dhënien e ndihmës së parë, dhe të trajnoj një numër të punëtorëve për dhënien e ndihmës së parë.

Neni 17

1. Me qëllim të avancimit të sigurisë në punë formohet komiteti i sigurisë së INFRAKOS-it Komiteti i sigurisë përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv, Udhëheqësit e Departamenteve dhe Shefi i Shërbimit për Sigurinë në Punë
2. Komiteti i sigurisë takohet sipas nevojës ku shqyrton gjendjen e sigurisë, funksionimin dhe progresin për secilin Departament /Sektorë/Shërbim nga kjo lëmi.

III. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E TË PUNËSUARVE

Neni 18

1. Të punësuarit kanë të drejtë në siguri, shëndet dhe ambient të sigurt të punës.
2. Të punësuarit obligohen t'i zbatojnë dhe t'iu përmbahen masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij/saj dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet dhe aktivitete në punë, të shfrytëzon në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë dhe PPM-në, t'i përdor me kujdes dhe t'i mbajë në gjendje funksionale.
3. Aty ku mbrojtja e përhershme dhe gjithëpërfshirëse nuk është e mundur, ose mungojnë PPM-të të punësuarit duhet menjëherë të njoftojnë personin e autorizuar për Siguri në punë për çdo mangësi, rrezik shëndetësor, defekt ose ndonjë dukuri tjetër e cila mund ta rrezikoi sigurinë e tij/saj ose të të punësuarve të tjerë.
4. I punësuarit ka të drejtë ta refuzojë punën, nëse ai/ajo ka arsye të besojë se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tij/saj. Nëse përgjegjësi i drejtpërdrejtë konsideron se refuzimi i punës është i pabazuar menjëherë duhet ta lajmëroi zyrtarin për siguri në punë.
5. I punësuarit bashkëpunon me përgjegjësin e drejtpërdrejtë dhe zyrtarin për siguri në punë për t'u siguruar se mjedisi i punës dhe kushtet e punës janë të sigurta dhe se masat e rekomanduara zbatohen në plotësi.
6. Është e drejtë e të punësuarve të konsultohen me përgjegjësin e drejtpërdrejtë për të gjitha aspektet e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit dhe ambientit të punës.
7. Të punësuarit shfrytëzojnë të gjitha makinat, pajisjet, veglat, materialin punës dhe mjetet e transportit si dhe aparatet e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse (PPM) në pajtim me udhëzimet përkatëse.
8. Të punësuarit me lidhjen e marrëdhënies së punës ose pas mungesës së gjatë në punë duhet të njoftohet me kushtet e punës dhe rreziqet në vend të punës, me rregullat dhe masat e mbrojtjes në punë dhe me të drejtat dhe përgjegjësitë lidhur me sigurinë në punë.
9. Të punësuarit kanë të drejtë në përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe shëndetit në vendin e punës dhe në vazhdimësi duhet të freskojnë dhe rrisin njohuritë e tyre nga fusha e sigurisë në punë.
10. Të punësuarit të cilin nuk u përmbahet masave të parapara të sigurisë në punë janë përgjegjës sipas Rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 19

Në rast rreziku të pashmangshëm kërcënues për vete dhe për personat tjerë, të punësuarve iu lejohe të ndërmarrë masat të përshtatshme, për të evituar rrezikun, marrë parasysh mjeteve teknike në dispozicion dhe trajnimin që ka marrë.

Neni 20

1. Përgjegjësi i drejtpërdrejtë është i obliguar ta largoj nga aktiviteti ditorë punëtorin nëse:
 - a. ka probleme shëndetësore ,

- b. nuk i shfrytëzon PPM-të,
- c. nuk e ka trajnimin e duhur dhe /ose të ripërtërirë për aktivitetin i cili realizohet
- d. është nën ndikim të alkoolit,
- e. është përdorues i barërave dhe narkotikëve.

IV. TRAJNIMI, NDËRGJEGJËSIMI, KOMPETENCA DHE AFTËSIMI NGA FUSHA E SIGURISË NË PUNË

Neni 21

1. Është përgjegjësi e Menaxhmentit të Infrakos-it të siguroj trajnim adekuat për të gjithë personelin i cili kryen funksione të cilat krahas operimit ndikojnë në sigurinë e komunikacionit hekurudhor, kujdesin shëndetësor, sigurinë në punë dhe mjedis të shëndetshëm.
2. Shërbimi për Shkollim, Mbrojtje dhe Siguri në Punë së bashku me Trupën e Auditimit të Brendshëm do të jetë përgjegjëse për kontrollimin e regjistrave të shkollimit (trajnitimit) të Sigurisë në Komunikacion, Kujdesit Shëndetësor dhe Mbrojtjes në Punë .
3. Menaxhmenti i Infrakos-it është përgjegjës për të siguruar menaxhim adekuat, aftësi të mira dhe të kërkuara të të punësuarve dhe ngritjen e tyre përmes trajnimeve.

Neni 22

1. Ndërgjegjësimi mbi strukturën organizative të kompanisë, rregullativën ligjore, përshkrimin e detyrave të punës dhe rregullat e përgjithshme të kompanisë përfshirë kodin e etikës.
2. Njoftimi me të gjithë të punësuarit, vendosja në vendin e punës, pajisja me pajimet e nevojshme për punë si dhe pajimi me PPM nëse e kërkon vendi i punës .

Neni 23

Programi themelor për arsimimin dhe trajnimin nga fusha e sigurisë në punë përpilohet nga Shërbimi përkatës për shkollim dhe trajnime, në koordinim me Burimet Njerëzore dhe njësitë profesionale dhe i dërgohet për aprovim Kryeshefit Ekzekutiv.

Neni 24

1. Organizimi i trajnimit nga fusha e Sigurisë dhe Emergjencave bëhet përmes Shërbimit përkatës për Shkollim dhe Trajnime, Mbrojtjes kundër Fatkeqësive Natyrore dhe personelin për siguri i cili është i trajnuar dhe i certifikuar.
2. Trajnimi mbahet në objektet e INFRAKOS-it i përshtatshëm për trajnim. Këtij trajnimi i nënshtrohen të gjithë punonjësit i INFRAKOS-it
3. Me rastin e zëvendësimit të punonjësit udhëheqësi i drejtpërdrejt është i obliguar para fillimit të punës të trajnoi personelin e ri.
4. Trajnimi i punëtorëve për punë duhet të bëhet në atë mënyrë e cila siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tij/saj dhe e cila parandalon fatkeqësitë në punë. Të punësuarit trajnohen për përdorimin e drejtë të mjeteve në pajtim me planin emergjent dhe në raste emergjente të veprohet sipas planit për evakuim.
5. Dosja e trajnimit të personelit mbahet dhe përditësohet nga Shërbimi për Shëndet dhe Siguri në Punë në INFRAKOS.

Neni 25

Për dhënien e ndihmës së parë duhet të jenë të aftësuar 10 % e të punësuarve në INFRAKOS, dhe të shpërndarë në të gjitha grupet e procesit të punës dhe ndërrimeve.

Neni 26

1. Punëtorët dhe personeli tekniko-mbikëqyrës të cilët janë drejtpërsëdrejti në ekzekutiv në provimet periodike, janë të obliguar t'i nënshtrohen edhe pyetësorit nga rregullat e sigurisë në punë.
2. Në provim është e nevojshme të tregohet aftësi nga programi për arsimim dhe trajnim për mbrojtjen në punë sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 27

Rregulloren, informatorët, doracakët dhe udhëzimet tjera për punën dhe organizimin e dhënies së ndihmës së parë, dhe trajnimet nga lëmia e sigurisë dhe emergjencave i përgatit dhe i shpërndanë Zytari për Siguri në bashkërendim me Departamentin e Shërbimeve të Korporatës.

Neni 28

Provimet nga lëmia e sigurisë në punë për punëtorët dhe personelin tekniko - mbikëqyrës të Sektorëve të INFRAKOS-it organizohen një herë në vit.

Neni 29

Komisionin për verifikimin e aftësive nga fusha e sigurisë në punë për personelin tekniko -mbikëqyrës e propozon Sektori i Burimeve Njerëzore, në përbërje të të cilit është edhe një zyrtar i Shërbimit për Shëndet dhe Siguri në Punë.

Neni 30

1. Punëtori i cili gjatë verifikimit të aftësive nuk ka treguar aftësi të mjaftueshme, nuk mund të mbetet në atë vend pune për aq kohë përderisa në verifikimin tjetër nuk tregon rezultat të kënaqshëm.
2. Afati i ri për verifikim tjetër të aftësive caktohet me vendim të posaçëm në përputhje me këtë Rregullore, ky afat nuk mund të jetë më pakë se 30 ditë.

Neni 31

Punëtori i cili nuk e ka kaluar provimin gjatë verifikimit të aftësive e humb të drejtën për ushtrimin e detyrës paraprake dhe ri-sistemohet, e njëjta masë aplikohet edhe për Punëtorin i cili pa arsytim nuk merr pjesë në provim për verifikimin e aftësive,

Neni 32

Për vendet e punës ku kërkohet aftësi e posaçme profesionale punëtori duhet të ketë certifikatë të posaçme përkatëse për aftësim adekuat.

V. MBROJTJA E TË RINJËVE, GRAVE DHE PËRSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 33

1. Udhëheqësit e sektorëve identifikojnë punëtorët e vet me nevoja të veçanta, për të cilët duhet të tregohet kujdesi shëndetësor dhe siguri në punë.
2. Punonjësit deri në moshën 18 vjeçare, gratë shtatzëna, dhe personat me nevoja të veçanta, nuk mund të punojnë në punë të cilat për nga natyra apo rrethanat nën të cilat kryhen, mund ta dëmtojnë shëndetin dhe sigurinë në punë.

VI. FURNIZIMI SHFRYTZIMI, KONTROLLIMI I KOHË PAS KOHSHËM I MJETEVE DHE VEGlave TË PUNËS

Neni 34

Mjetet e punës i furnizon shërbimi i autorizuar dhe gjatë furnizimit duhet të ketë kujdes që këto mjete dhe pajime të posedojnë a-testet dhe certifikatat me të cilat vërtetohet cilësia e tyre nga aspekti i sigurisë në punë sipas standardeve të BE-së.

Neni 35

1. INFRAKOS Obligohet të mbajë:
 - a. certifikatat teknike të cilat qartë specifikojnë aplikimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, hapësirave të punës, hapësirave në shfrytëzim,
 - b. udhëzimet mbi përdorimin e gjithë makinerisë dhe të pajisjeve në procesin e punës, dhe masat e sigurisë,
 - c. certifikatat të cilat vërtetojnë se instalimet janë në rregull dhe tregojnë qartë karakteristikat e makinës në përdorim, në pajtim me standardet Evropiane
 - d. evidencën për programet për trajnimin e punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurtë,
 - e. evidencën për kontrollimin paraprak dhe periodik mjekësor të punëtorëve,
 - f. evidencën për substancat e dëmshme të cilat në procesin e punës lirohen,
 - g. evidencën për aksidentet në punë, rastet e lëndimeve dhe lëndimeve vdekjeprurëse, kolektive dhe rastet e sëmundjeve profesionale,
 - h. evidencën për rezultatet e të gjitha vlerësimeve për rreziqet, masat e ndërmarra për t'i eliminuar rreziqet e tilla dhe rezultatet e kontrollimeve mbi efektivitetin e masave,
 - i. evidencën për ndryshimet në proceset e punës të cilat rrezikojnë ose mund të paraqesin rrezik për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.
2. Materialet (traversat, llamarinat, çelikut, tubat, vajrat, kemikatet dhe pajisjet etj.) për procesin e punës duhet të kenë a-teste dhe certifikata për cilësi sipas standardeve teknike.

Neni 36

Me qëllim të sigurimit të kushteve profesionale për punë, sektorët, shërbimet në INFRAKOS janë të obliguara që rregullisht sipas rekomandimeve teknike të bëjnë verifikimin dhe kontrollimin e gjendjes së mjeteve, pajisjeve dhe stabilimenteve të cilat shfrytëzohen për punë.

Neni 37

1. Sipas rregullave teknike mjetet, pajisje dhe stabilimenteve të cilat shfrytëzohen për punë në INFRAKOS, detyrimisht i nënshtrohen kontrollit, këtu bëjnë pjesë :
 - a. Vinçat ngarkues,
 - b. Pajisjet për ngritje dhe bartje të peshave,
 - c. Litarët e çeliktë të pajimeve peshëngritëse dhe të tjera,
 - d. Sistemet e frenimit,
 - e. Kompresorët dhe stacionet e kompresorëve
 - f. Enët me acetilen, oksigjen etj.
 - g. Sistemin termo-energetik , ekspanduesit në ngrohtore ,
 - h. Trafo stacionet dhe pajimet elektrike,
 - i. Instalimet e tensionit të lartë dhe të ulët,
 - j. Matja dhe kontrolli i pajisjeve elektrike,
 - k. Instalimet e për tokëzimit dhe rrufepritësve,
 - l. Kontrolli dhe testimi i mbrojtjeve dhe bllokadave,
 - m. Shtëllimi dhe testimi i valvuleve sigurorese.
2. Mekanizmat dhe veglat e dorës dhe mjetet dhe pajimet për të cilat kërkohet kontrollimi – a-testimi periodik sipas rekomandimeve, rregulloreve apo ligjit.

Neni 38

1. Me qëllim të sigurimit të kushteve profesionale të punës Sektorët/Shërbimet në INFRAKOS janë të obliguara që në afatet e parapara të bëjnë verifikimin dhe kontrollimin e rregullsisë së mjeteve të punës.
2. Afatet kohore të shqyrtimeve dhe testeve duhet të respektohen sipas rekomandimeve teknike të prodhuesve.

Neni 39

Punëtorët gjatë përdorimit të: mjeteve dhe veglave për punë janë të obliguar që rreptësisht të respektojnë udhëzimet dhe normat e rekomanduara nga prodhuesi si dhe rregullat e sigurisë në punë.

Neni 40

Të gjitha aparatet dhe pajimet, që punojnë me energji elektrike, avull, gaz dhe me ujë duhet të jenë në harmoni me rregullat teknike në fuqi nga kjo fushë.

VII. MASAT E SIGURISË NË OBJEKTET E INFRAKOS-it

Neni 41

Gjatë projektimit dhe ndërtimit të objekteve të Infrakos-it, të dedikuara për zyre, punëtori, lokale afariste, projektuesi është i obliguar t'iu përmbahet rregullave dhe standardeve nga siguria në punë.

Neni 42

Të punësuarve duhet vënë në dispozicion numër të mjaftueshëm të tualeteve dhe dhoma të ndërrimit ndaras për femra, ndaras për meshkuj dhe t'i mirëmbajnë ato në mënyrë adekuate.

Neni 43

Të punësuarve që punojnë me substanca të rrezikshme ose në ambiente të ndotura duhet t'iu sigurohen mjete për pastrimin e rrobave të punës dhe mjete për mbajtje të higjienës personale.

Neni 44

Zhurma, dridhja dhe dritat duhet të matën dhe kontrollohen nga institutet e autorizuar përkatëse. Niveli i zhurmës dhe dridhjes, duhet të rregullohet dhe të sillen në kufi të lejuar në pajtim me standardet Evropiane.

Neni 45

Të gjitha pajisjet elektrike, duhet të kenë etiketën, në të cilën shënohen karakteristikat e tyre me simbolin CE. Instalimet e rrymës duhet bëhen në pajtim me Standardet Evropiane (EN).

Neni 46

1. Të gjitha pajisjet me burim energjie elektrike të montuara, të jenë të sigurta, të izoluar.
2. Kjo kur nuk është e mundur atëherë për të parandaluar kontaktin e operatorit me pjesën e rrezikshme duhet përdorur ndonjë mjet sigurie dhe të njëjtat të inspektohen rregullisht nga elektrikisti i kualifikuar.

Shtypësit dhe kompjuterët personal

Neni 47

1. Shtypësit dhe kompjuterët personal (PC-së) janë pajisjet më të zakonshme në zyre, me burim energjie elektrike, po ashtu pesha e tyre është variabile mund të jenë edhe të rënda.
2. Nevoja për t'i lëvizur shpesh nga një vend në tjetrin kërkon kujdes dhe përkushtim i vëmendjes. Punonjësit rekomandohen që pajisjet e tilla t'i vendosin në sipërfaqe të rrafshët të fortë.
3. Shtypësi dhe kompjuteri nuk duhet të vendoset në afërsi të mureve për të evituar pengesën e rrymimit të ajrit, ngase mund të shkaktohet nxehja e pajisjes me këtë edhe zjarri.
4. Me rastin e pastrimit të pajisjes sigurohu se pajisja është e shkyçur nga burimi i energjisë elektrike.
5. Punonjësit obligohen t'i shkyçin pajisjet elektrike para se të largohesh për një kohë më të gjatë nga zyra.

Siguria në qendrën kontrolluese për lëvizjen e trenave (QKLT)
Neni 48

1. Rreziku nga përdorimi i Pajisjeve Elektronike shkakton pasoja si në vijim, por jo vetëm:
 - a. Dhimbjet e ekstremiteteve të epërme dhe tendosje e përsëritur si rezultat i ekspozimit të zgjatur statik dhe pozicioni i duarve dhe kyçeve. Gjithashtu mund të përfshij qafen dhe dhimbjet e lehta të shpinës.
 - b. Problemet në shikim me lëndimin e syve dhe dhimbje të kokës, stresi dhe lodhja si rezultat i ngarkesës organizative të komunikacionit hekurudhor, reagimet e shpejta në punë dhe mungesa e kontrollit mbi punën.
2. Masat preventive për reduktimin e rrezikut:
 - a. Me qëllim të reduktimit të rrezikut nga përdorimi i pajisjeve duhet të merren masa në ri-pozicionimin e pajisjeve, rregullimin e karrigeve, përmirësim në ndriçim, ri-organizimi në punë .
 - b. Përcaktimi i madhësi adekuate të ekraneve dhe karaktereve të ndara. Pamje (imazhe) të qëndrueshme, rregullim i lehtë i shkëlqimit dhe kontrastit. Pajisje për lëvizje rrethore dhe tavolina me rregullim të pjerrësisë, pa shkëlqim reflektues, hapësirë e mjaftueshme për të ofruar mbështetje për kyçe dhe krah, hapësirë të mjaftueshme e cila krijon mundësi të ndryshimit të pozicionit dhe lëvizje të ndryshme.
 - c. Operuesit me ekrane duhet të marrin pushime të shpeshta nga ekrani, duke ndryshuar modelin e punës ose duke u marr me punë tjera të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me shikimin në ekran.
 - d. Zëri dhe nxehtësia e cila shqetëson ose pengon në të dëgjuar nuk lejohet. Pajisjet nuk duhet të prodhojnë nxehtësi e cila e tejkalon dhe e cila shkakton vështirësi në punë për shfrytëzuesit.

Neni 49

Vendi i punës duhet të jetë i pajisur me mjete përkatëse kundër zjarrit në pajtim me planin e Emergjencave të Infrakosit. Lëvizja apo ecja e punonjësve pran tavolinës së hapur mund të shkaktojnë lëndime të këmbëve. Punonjësit nuk duhet të përdorin karrige ose kuti për të arritur gjëra në lartësi në rafte. Rrugët e daljes në zyrat e mëdha dhe dhoma pune duhet të mbahen të lira në mënyrë që punonjësit mund të largohen me shpejtësi në raste emergjente.

Neni 50

Në raste emergjente, daljet duhet të jenë të shënuara, të jenë të lira, të kenë ndriçim emergjent dhe nuk guxojnë të jenë të mbyllura me çelës.

Neni 51

INFRAKOS obligohet të hartojnë planin Emergjencave për evakuimin e njerëzve dhe pajisjeve lëvizëse në situata të jashtëzakonshme.

Neni 52

Ndotja e ajrit nga pluhuri dhe gazrat duhet të menaxhohen dhe mirëmbahen përmes ventilimit dhe formave tjera, në atë mënyrë që të parandalojnë përqendrimet që dëmtojnë shëndetin ose pengojnë pamjen, në përputhje me Standardet Evropiane.

Politika dhe Procedurat – Duhani- Drogat-Alkooli dhe Armët,
Neni 53

1. Në ambientet e mbyllura të punës, ndalohet pirja e duhanit. INFRAKOS obligohet të vendos shenja për mos lejin e pirjes së duhanit, dhe të caktoj hapësirat ku është e lejuar pirja e duhanit, dhe të siguroj ato vende në kuptimin e mbrojtjes kundër zjarrit.
2. Në ambientet e punës, ndalohet konsumimi i pijeve alkoolike, përdorimi i drogave qoftë i qëllimshëm ose i pa qëllimshëm.
3. Në situatat kur një punonjës është duke marrë drogë (barëra) të përshkruara si medikamente për trajtim të një gjendje shëndetësore, punonjësi është përgjegjës për informimin e eprorit të tij me qëllim të evitimit të efektit potencial cenus.
4. Punonjësit që konsumojnë alkool përderisa janë jashtë shërbimit do të jenë përgjegjës për të siguruar kohën e mjaftueshme për të ulur ndikimin e alkoolit deri në kohën e fillimit të punës. Kufiri i prezencës së alkoolit në gjak për të punësuarit është sipas ligjit 0.05%.
5. Testet tremujore të rregullta për prezencën e alkoolit në gjak do të bëhen për makinist, dhe vozitës në logjistikë por ka mundësi edhe kontrole pa paralajmërim për tërë stafin e INFRAKOS-it.
6. Nëse zbulohet varësia e alkoolit/ drogës nga një kontrollim disiplinorë atëherë merren masa disiplinore duke iu nënshtuar procedurave të rregullta disiplinore. Varësia nuk do të konsiderohet si një rrethanë lehtësuese në procedurë disiplinore.
7. Posedimi, shpërndarja, shitja apo përdorimi i alkoolit dhe drogave të paligjshme, ose keqpërdorimi i drogave legale, në lokalet dhe mjediset e punës në INFRAKOS konsiderohen si shkelje të rënda. Masa normale disiplinore për sjellje të keqe do të jetë përmbledhje shkarkimesh. Në rast se çfarëdo droge ilegale është gjetur ose dyshohet për veprimtari në mjediset e INFRAKOS-it, do të kontaktohet policia.
8. Pamundësia e një punonjësi për të kryer detyrat e tija duke qenë nën ndikim të alkoolit, ose përdorimit të drogave ose drogave legale do të konsiderohet shkelje e rëndë.
9. Në situatë kur ka bazë të arsyeshme për të dyshuar se alkooli ose droga mund të ketë qenë e sjell në hapësirat mjedisore të INFRAKOS-it, do të ndërmerren kontrollime dhe kërkime për alkool dhe droga të pa ligjshme. Dështimet për të bashkëpunuar do të konsiderohen si shkelje të rënda.

Neni 54

Mbajtja e armës është e ndaluar në të gjitha lokalet dhe hapësirat e punës në INFRAKOS. Kushdo që mbanë armë duhet të largohet arma e tij me sigurimin e kompanisë para se të hyjë në lokalet e INFRAKOS-it me përjashtim të policisë dhe autoriteteve qeveritare.

VIII. MASAT E SIGURISË GJATË BARTJES SË PUNËTORËVE

Neni 55

Masat e sigurisë duhet të zbatohen gjatë bartjes së punëtorëve në punë dhe nga puna, brenda fushëveprimit të punëve operative.

Neni 56

INFRAKOS obligohet që për të gjitha rrugët e brendshme, të vendos shenja përkufizimin dhe shpejtësinë e lëvizjes së mjeteve motorike dhe t'i sigurojë të gjitha shenjat e komunikacionit.

Neni 57

1. Ndalohet që punëtorët të barten me mjete të papërshtatshme dhe të rrezikshme për jetën e tyre siç janë: autovinçi, piruneri, luga-ngarkuese, mjetet ndezëse dhe materiet helmuese e të ngjashme me këto.

2. Ndalohet ecja nëpër shina (binarë), në ura ku nuk janë të vendosur platforma për këmbësorë, në raste të urave të mëdha metalike edhe pa mbrojtje anësore.

Neni 58

Punëtorët të autovinçave, ekskavatorëve hidraulik dhe makina të tjera të rënda hekurudhore u ndalohet puna me makina nën largpërçues dhe lokacione tjera ku mund të rrezikohet jeta apo pajisja gjatë punës.

Neni 59

1. Ndalohet çdo punë (riparim, pastrim dhe punë tjera) nën dhe mbi makina të rënda hekurudhore përderisa ato janë në punë/lëvizje, dhe temperatura të lartë si dhe në çdo vend që paraqet rrezik për jetën e njeriut. Para fillimit të punëve duhet të ndermirren të gjitha masat mbrojtëse dhe sigurorese për punë pa rrezik për personelin dhe pajimet.
2. Për të gjitha punët dhe veprimet me shkallë të lartë të rrezikut është obliguese dhënia dhe marrja e lejeve të punës me masa shtesë të sigurisë.
3. Për të gjitha operimet e stabilimenteve nën tension hartohen procedurat e veçanta për operim nën tension si dhe mënyra e komunikimit.

Neni 60

Me rastin e transportimit të materieve lehtë ndezëse dhe helmuese duhet aplikuar masat e parapara me ligj dhe rregulla të transportit për këtë veprimtari.

Neni 61

1. Punëtorët jo kompetent dhe të pa autorizuar nuk guxojnë të punojnë dhe operojnë me pajisje elektrike.
2. Pajisjet elektrike duhet të jenë të siguruara dhe të shënuara me shenja adekuate standarde.
3. Në lokalet ku janë të vendosura pajisjet elektrike të tensionit të lartë, nuk lejohet qasja e punëtorëve jo kompetent dhe të pa autorizuar. Hapësirat duhet të mbahen të mbyllura dhe të siguruara nga qasja e personelit të pa autorizuar.

Neni 62

1. Kur kryhen punë në pajisje elektrike, dhe ekziston mundësia e prekjes së rastësishme në pjesët nën tension apo rreziku nga fusha elektrike, tensioni fillimisht duhet të ç 'kyçët, të bëhet tokëzimi dhe të përdorën të gjitha masat dhe mjetet e sigurisë në punë të cilat janë të parapara me procedura për ç 'kyçje dhe kyçje si dhe rregullat teknike.
2. Objektet duhet të jenë të mbrojtura me rrufepritës.

Neni 63

1. Ndalohet heqja e shenjave të sigurisë, keqpërdorimi dhe dëmtimi i tyre.
2. Shenjat mbrojtëse mund të hiqen vetëm atëherë kur të aftësohet mjeti ose kur ai të zëvendësohet.
3. Pas mbarimit të punës, sipas paragrafit paraprak punëtori i cili e ka larguar shenjen e sigurisë është i obliguar që atë ta rikthejë në gjendje të mëparshme.

IX. PËRDORIMI I SIGURT I MAKINERISË

Neni 64

1. Është përgjegjësi e mbikëqyrësit të siguroi se punonjësit të cilët operojnë me këto makineri janë të përgatitur për standardet që do të aplikohen dhe për rreziqet e mundshme.
2. Së bashku me kryerësit e punës në vend pune të sigurojnë që të gjitha pajisjet ngritëse janë inspektuar, testuar, regjistruar dhe të sigurta për përdorim dhe në përputhje me standardet.
3. Mbikëqyrësi i punëtorisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të këtyre pajisjeve dhe për planifikimin e mirëmbajtjes për të siguruar se inspektimi, testimi dhe ri-certifikimi janë kryer në intervale kohore të kërkuara.

Operimet në Punëtori

Neni 65

1. Rreziqet kryesore që shoqërohen me operim në punëtori ndahen në këto kategori të përgjithshme.
 - a. Përdorimi i veglave të punës ose pajisjeve mobile,
 - b. Përdorimi i veglave të dorës dhe Mirëmbajtja e punëtorisë,

Veglat makinerie

Neni 66

1. Veglat e makinerisë mund të jenë të instaluara dhe fikse, dhe si të tilla mund të konsiderohen se janë të sigurta nëse:
 - a. Kanë mbrojtëset e përshtatshme për t'u mbrojtur nga të gjitha pjesët e lëvizshme,
 - b. Kontrolli të jetë i dizajnuar dhe i vendosur ashtu që duart e operatorit nuk mund të bllokohen ose të lëndohen nga makineria,
 - c. Kontrolli "STOP" të jetë qartë i dukshëm dhe të jetë i vendosur që me lehtësi të arrihet nga operuesi.
2. Inspektimi i rregullt duhet të bëhet nga mbikëqyrësi për të siguruar se të gjitha pajisjet funksionojnë dhe janë në përdorim dhe se vetëm personi kompetent dhe i trajnuar duhet të përdor veglat e caktuara të makinerisë.
3. Operatori gjatë gjithë kohës duhet të merr masa në lidhje me sigurinë. Sa herë që shfaqet rreziku nga fluturimi i copëzave ose nga pluhuri i krijuar, operatori duhet të vendosë syzat mbrojtëse, të ketë të veshur gardërobën dhe mantelin e punës, dorëza të përshtatshme për të mbrojtur duart dhe helmetën mbrojtëse.

Veglat mobile

Neni 67

Veglat siç janë: për shpim, për gërryerje etj. duhet të jenë në kushte të mira mekanike dhe elektrike para se ato të përdoren. Mbrojtja personale (psh. mbrojtja e syve, maska kundër pluhurit, mbrojtësit e veshit nga zhurma, dorëzat, etj.) duhet të përdoren ose vendosen siç kërkohet.

Gërryerja e diskut dhe bluarja e diskut

Neni 68

Gërryerja dhe/ose bluarja e diskut të gurit mund të jetë shumë e rrezikshme nëse vendosen ose përdoren gabimisht. Për të evituar rreziqet duhet të ndërmerren dhe të respektohen masat sipas Nenit 66. Vetëm personat e trajnuar duhet të montojnë dhe përkujdesen për disqet abrazive dhe duhet të mbahet një regjistër me personelin e tillë.

Makineria lëvizëse

Neni 59

1. Të gjitha makineritë lëvizëse i nënshtrohen shqyrtimit në intervalet vjetore të rregullta,
2. Makinat ose veglat mobile duhet të ruhen vetëm në depot e autorizuara të veglave,
3. Të gjitha makinat ose veglat makinerie duhet të jenë të numëruara dhe regjistrat e mirëmbajtjes duhet t'i referohen këtij numërimi,
4. Të gjitha makinat ose veglat makinerie duhet të plotësohen me masa mbrojtës adekuat dhe mbrojtëset e tilla nuk do të hiqen pa leje dhe mbikëqyrje.
5. Makineritë me sisteme pneumatike: të gjitha lidhjet e tubacioneve të ajrit duhet të jenë të lidhura ose salduara dhe të sigurta.
6. Çelësi / këmbëza nuk duhet të jetë e lidhur ose siguruar për pozitën "për"; "ON",

Saldimi dhe prerja

Neni 70

1. Rekomandimet e mëposhtme të sigurisë dhe masat paraprake për operacionet e saldimit dhe prerjes duhet të ndiqen në çdo rast të përdorimit të pajisjeve për saldimit dhe prerje.
2. Përveç kësaj, duhet të kërkohet edhe një leje për punë me rrezikshmëri nëse puna duhet të kryhet në një zonë të kufizuar ose si pjesë e kërkesave kontraktuese të klientit.

3. Mbikëqyrësit sigurojnë se të gjitha operacionet e saldimit janë kryer nga persona kompetent dhe se janë të informuar për masat e sigurisë para se të lejohet nisja e punës.

Neni 71

1. Të gjitha operacionet e saldimit dhe prerjes duhet të kryhen vetëm pas miratimit të mbikëqyrësit.
2. Asnjë personi të paautorizuar nuk i lejohet të përdorë pajisjet e saldimit.
3. Salduesit duhet të mbahen përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve të tyre dhe për të siguruar se punohet me kujdesin maksimal për sigurinë personale dhe të personave të tjerë. Saldatorët me saldim elektrik duhet të mbajnë ekranet mbrojtëse dhe nuk duhet të lejojnë askënd të shikojnë pa mbrojtje me ekrane.
4. Rrobat mbrojtëse personale dhe pajisjet tjera mbrojtëse duhet të vishen gjatë saldimit dhe prerjes ku përfshihen: syzet, helmetat dhe mbrojtja e fytyrës, mbrojtës të krahut prej lëkure dhe dorëza, etj. ndihmësit e saldatorit, kolegët të cilët do ta shoqërojnë ose të cilët punojnë në afërsi me saldatorin po ashtu duhet të vendosin pajisjet mbrojtëse si dorëzat, syzet etj.
5. Saldimi me autogjen duhet të realizohet në sipërfaqen e lirë. Salduesit gjithnjë duhet të qëndrojnë në anën e kundërt të çfarëdo rregulluesi kur presioni është i hapur.
6. Të gjitha çeliquet e tubacioneve, enëve të cilat janë të mbushura me lëngje avulluese ose gazra të paqëndrueshme duhet të zbrazen tërësisht duke i mbushur me ujë ose me ndonjë metodë tjetër të sigurt të miratuar para se të aplikohet saldimi ose prerja,
7. Pjesët e materialit të nxehtë nuk duhet të lihen në vendin ku mund të preken ose të shkelen ngase punonjësit e tjerë. Praktikë e mirë është shënjimi me shenjë ku tregon se punohet ose rrezik nga “zjarr”.
8. Energjia elektrike duhet të kthehet në pozicionin e shkyçur kur pajisjet nuk janë përdorim për një periudhë ma të gjatë psh. periudha e drekës dhe gjatë natës,
9. Para se të filloi çfarëdo saldimi ose prerje, veçanërisht në punët në lartësi, bëhet sigurimi që shkëndijat nuk bien poshtë salduesit ose vend punimit në asnjë person dhe/ose ndonjë material i cili lehtë mund të ndizet.

Bombolat me gaz të ngjeshur

Neni 72

1. Pranimi e bombolave të gazit të cilat duhet të jenë në gjendje të mirë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të shënimit me ngjyra ose të shkruara, zyrtari i autorizuar kujdeset që të njëjtat të jenë të plotësuar.
2. Të gjitha bombolat e gazit duhet të ruhen në hapësira të hapura të veçuara për të evituar rreziqet, eksplozimin, përkeqësimin, nxehjen ose reaksionin. Bombolat nuk duhet t'i ekspozohen drejtpërdrejt diellit.
3. Transportimi i bombolave duhet të bëhet sipas standardeve, të kenë kapakët për mbrojtjen e vendeve ku mbërthehen valvulet, dhe duhet me kujdes të vendosen në automjetet ose në kutit speciale për transport.
4. Bombolat e gazit gjithnjë duhet plotësuar standardet e sigurisë dhe të shfrytëzohen në formë të rregullt me tubacione të duhura dhe matës të presionit.
5. Flakë-hedhësi duhet të mbyllet komplet edhe në kurorë nëse nuk është në përdorim.

Enët nën presion

Neni 73

1. Të gjitha enët nën presion, valvulet e sigurisë duhet të testohen rregullisht në përputhje me standardet, si dhe të regjistrohen para se të futen në shërbim.
2. Mbikëqyrësi duhet të përkujdeset rregullisht në baza javore dhe t'i kontrolloj të gjitha enët nën presion dhe pjesët shtesë që janë në kompetencë të tyre ose enët të cilat janë nën kontrollin e tyre.

3. Enët nën presion të cilat konstatohet se janë të dëmtuara, me defekte ose kërkojnë riparim, duhet menjëherë të largohen nga shërbimi i tyre.

Shkallët
Neni 74

1. Të gjitha shkallët të cilat janë në shfrytëzim të përgjithshëm duhet të jenë të ngjitura në fillim dhe në fund; shkallët e gjata duhet të sigurohen në pikat e ndërmjetme dhe nuk guxojnë ta kalojnë gjatësinë mbi 6 metra.
2. Përdorimi i shkallëve mobile në sipërfaqet të fortë, mundet pasi të jenë veshur me mbathje të gomës të cilat evitojnë rrëshqitjen. Majat duhet të sigurohet për të mos rrëshqitur.
3. Shkallët përgjithësisht dizajnohen për të mbajtur peshën e vetëm një njeriu, në një kohë. Vetëm një person duhet të jetë në shkallë në çfarëdo kohe që është e nevojshme përjashtim mund të bëhet vetëm me urdhrin e mbikëqyrësit,
4. Shkallët nuk duhet të vendosen në drejtim të hapjes së derës me përjashtim kur dera është e mbyllur me çelës, shmangeni shtrirjen ose përkuljen nga shkallët.
5. Duhet siguruar shkallët sa herë që punohet në maje të shkallëve ose kur janë të pa qëndrueshme.

Masat paraprake të sigurisë në ruajtjen e makinerisë
Neni 75

1. Të ndërmerren masa të duhura për të përshtatur dhe riparuar pjesët e makinerisë, të mbyllura me masat mbrojtëse duke mos lejuar ekspozimin e rrezikut për punonjësit,
2. Masat mbrojtëse duhet të dizajnohen ashtu që lubrifikimi i tyre mund të bëhet pa demontim kur kjo është e mundur.
3. Kur mirëmbajtja kërkon largimin e mbrojtëseve të makinave, të gjitha kyçet elektrike duhet të shkyçen nga prizat kyçëse të energjisë ma lehtë se sa të shkyçet siguresa kryesore.
4. Siguresat mbrojtëse janë pajisje të cilat e ndalojnë qasjen në makineri në pjesët e rrezikshme. Kjo zakonisht përbëhet nga një mekanizëm që e eliminon ose parandalon lëvizjen ose fuqinë lëvizëse.

Mirëmbajtja e punëtorisë
Neni 76

Mirëmbajtja e punëtorisë është shumë me rëndësi të bëhet gjithnjë duke e pastruar dhe renditur veglat siç duhet.

X. USHQIMI I PUNËTORËVE

Neni 77

Hapësirat për ngrënie, duhet të jenë të pastërta, të ajrosura, me nxehtësi të mjaftueshme dhe lagështi të lejuar, dhe të pa ndikuar nga atmosfera e dëmshme. Vendet e ngrënies duhet të pajisen me ujë, tavolinë dhe ndonjë inventar të domosdoshëm. Shërbimet përkatëse duhet të kujdesen dhe organizojnë mirëmbajtjen e këtyre hapësirave me stafin e shërbimit.

Neni 78

Punëdhënësi është i obliguar të siguroi sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të punësuarit, sipas natyrës së punës dhe vendit të punës.

Neni 79

Zyrtari i sigurisë në punë në bashkëpunim me udhëheqësin e shërbimit/sectorin kujdeset për plotësimin e kushteve higjienike në objektet e punës.

Neni 80

Analiza e ujit të pijshëm dhe nevojat sanitare duhet të kryhen në mënyre periodike sipas rregullave ligjore.

Hapësirat e punës dhe ato ndihmëse duhet të jenë në harmoni me kushtet higjienike dhe sanitare të parapara me rregullat në fuqi.

XI. MBROJTJA SHËNDETSORE

Neni 81

INFRAKOS siguron mbrojtjen shëndetësore për të punësuarit përmes vizitave sistematike në institucione shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 82

1. Infracos përmes stafit të trajnuar është i obliguar që në rast të lëndimeve ose sëmundjes së papritur, punëtorit t'i ofroj:
 - a. dhënien e ndihmës së parë,
 - b. të siguroi evakuimin e të punësuarit-lënduarit nga vendi i ngjarjes.
 - c. siguroi dhe organizoi kontakte me shërbimin përkatës,
 - d. dhënien e ndihmës urgjente,
 - e. mbrojtjen kundër zjarrit,

Neni 83

Para lidhjes së kontratës së punës çdo punëtor është i obliguar që t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor.

Neni 84

INFRAKOS është i obliguar të bëjë vlerësimin e rrezikut për vendet e punës.

Neni 85

1. Rreziqet kategorizohen dhe burojnë nga :
 - a. Konstruktimi dhe pajisjet në vendin e punës,
 - b. Ndikimet fizike, kimike dhe biologjike,
 - c. Zgjedhja dhe përdorimi i mjeteve, materialit, përbërësve të pajisjeve dhe zbatimi i tyre.
 - d. Sistemimi dhe organizimi i punës, rrjedhës së punëve, orarit të punës dhe ndikimet e ndërsjella.
 - e. Mos kualifikimi dhe trajnimi i stafit.

Neni 86

Dhuruesit e gjakut, punëtorë të INFRAKOS -it, gjatë vitit kalendarik kanë të drejtë pushimi me pagës, sipas ligjit për çdo dhurues të gjakut.

XI. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 87

Personeli i sigurisë i përmbahet në tërësi akteve që rregullojnë këtë fushë.

Neni 88

1. Punëtori do të merret në përgjegjësi në këto raste:
 - a. Nëse masat e sigurisë janë plotësuar ndërsa detyrat e parapara nuk i kryen me rregull;
 - b. Nëse gjatë punës nuk i zbaton masat dhe normat e sigurisë në punë;
 - c. Nëse e largon e bënë të papërdorshme /dëmton/ mjetet dhe pajimet e sigurisë në punë;
 - d. Nëse nuk bënë mbikëqyrjen sipas autorizimit;
 - e. Nëse nuk i zbaton detyrat e posaçme, lidhur me sigurinë në punë.

XII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 89

Masat dhe normat e sigurisë në punë, të cilat zbatohen në INFRAKOS SH.A., janë të parapara në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, dhe Ligjin e Punës në Kosovë

Neni 90

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të INFRAKOS Sh.A.


znj, Edona NAHI
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
NP. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
INFRAKOS Sh.A